V E N D I M
Nr.325, datë 14.6.1993

PËR REGJIMIN E EKSPORT-IMPORTIT DHE PRODHIMIN E BARNAVE

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Importimi, eksportimi, prodhimi i barnave dhe i materialeve të tjera me përdorim mjekësor në Republikën e Shqipërisë bëhen me licencë të dhënë nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.

Importimi i specialiteteve të mirëfillta veterinare bëhet me licencë të dhënë nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

2. Barnat që importohen, eksportohen dhe prodhohen në vend, i nënshtrohen kontrollit cilësor në institucionet e specializuara të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, përpara se ato të kalojnë për përdorim.

3. Barnat që qarkullojnë dhe përdoren në praktikën mjekësore të vendit, të jenë të përfshira në emërtesën e barnave të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit, dhe të jenë të regjistruara.

4. Zhdoganimi i barnave që importohen bëhet:

a) Pranë ndërmarrjes Profarma në Tiranë, kur barnat importohen nga shteti.

b) Pranë pikave doganore përkatëse, kur barnat importohen nga persona juridikë a fizikë privatë, shoqata dhe individë bamirësish, në prani të një specialisti farmacist të autorizuar për këtë qëllim.

5. Në pikën doganore personat që shoqërojnë mallin, duhet të jenë të pajisur me dokumentacionin përkatës të nevojshëm që vërteton identitetin e mallit, vitin e prodhimit e të skadencës, sasinë dhe destinacionin përkatës të tij.

Mungesa qoftë edhe e njërit prej dokumenteve të caktuara sjell moslejimin e hyrjes në pikën doganore nga ana e organeve doganore.

6. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ngarkohen të nxjerrin udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.312, datë 20.7.1992 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.327, datë 28.8.1991 "Për regjimin e eksport-importit nga dhe në Republikën e Shqipërisë" shfuqizohet, kurse pika II e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.253, datë 22.6.1992 "Për fillimin e disa masave të programit të reformës ekonomike", nuk zbatohet për barnat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi